



# Republika e Kosovës

## Republika Kosova - Republic of Kosovo

Agjencia e Kosovës për Akreditim  
Agencija Kosova za Akreditaciju  
Kosovo Accreditation Agency



Data: 06.09.2016

Ref.: 806/16

Në mbështetje të nenit 4, dhe 23, të Ligjit për Administratën Shtetërore të Republikës së Kosovës (nr.03/L-189, datë 16.09.2010), neni 7, dhe neni 15 të Ligjit për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës (Nr. 04/L-037, datë 29.08.2011), Udhëzimin Administrativ për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës (Nr.02/2013, datë 16.01.2013), Këshilli Shtetërorë i Cilësisë (KSHC), në mbledhjen e 44-të, të mbajtur më 25 Gusht 2016, mori:

### V E N D I M

I. Riakreditohet programi i studimit i Fakultetit të Shkencave Matematike – Natyrore të Universitetit të Prishtinës “Hasan Prishtina” për periudhën tre vjeçare 1 tetor 2016 – 30 shtator 2019:

- Shkenca Kompjuterike, BSc, 180 ECTS, (maksimum 60 studentë për vit akademik)

II. Kuotat e caktuar më sipër për regjistrim e studentëve në programet e studimit, vlejné nga viti akademik 2017/2018.

III. Obligohet Fakultetit i Shkencave Matematike – Natyrore i Universitetit i Prishtinës “Hasan Prishtina” që deri me 1 tetor 2016 në Agjencinë e Kosovës për Akreditim ta dorëzoj planin e rekrutimit të stafit akademik, për vitin akademik 2016/2017, për arsyeje të pensionimit të mundshëm të stafit, apo për çfarëdo arsyeje tjetër.

IV. Obligohet Fakulteti i Shkencave Matematike – Natyrore i Universitetit të Prishtinës “Hasan Prishtina” që deri me datë 1 tetor 2016 të dorëzoj në Agjencinë e Kosovës për Akreditim (AKA) Planin e Implementimit të Rekomandimeve të dhëna në raportin final të ekspertëve ndërkombëtar të akreditimit.

V. Ky vendim hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

### A r s y e t i m i

Fakulteti i Shkencave Matematike – Natyrore i Universitetit të Prishtinës “Hasan Prishtina” ka parashtruar kërkesë pranë Agjencisë së Kosovës për Akreditim (AKA), për ri/akreditim të programit të studimit me stafin akademik si në vijim:

Nr.	Programi i studimit	Niveli	ECTS	Bartësit e Programit
1	Shkenca Kompjuterike	BSc	180	Faton Berisha, Naim Braha, dhe Menderes Gashi

AKA ka organizuar vizitën në Fakultetin e Shkencave Matematike – Natyrore të Universitetit të Prishtinës “Hasan Prishtina” më 30.05.2016, me ekspertët ndërkombëtar të akreditimit me këtë përbërje: Prof. Dr. Henrik Toft Jensen, Prof. Dr. Jens Hoegaard Jensen, Prof. Dr. Peeter Normak, Prof. Dr. Fekete Csaba, Prof. Dr. Mladen Krajacic, Prof. Dr. Predrag Novak, Prof. Dr. Vladislav Tomisic, dhe Ms. Arus Harutyunyan.

Këshilli Shtetëror i Cilësisë (KSHC) në mbledhjen e mbajtur më 25 Gusht 2016 ka vlerësuar aplikacionin e Fakultetit të Shkencave Matematike – Natyrore të Universitetit të Prishtinës “Hasan Prishtina”, dhe duke u bazuar në të gjeturat e ekspertëve të akreditimit gjatë realizimit të vizitës, rekomandimet përfundimtare të dhëna në raportin final nga ekspertët e cekur më sipër dhe plotësimin të stafit akademik (Dr.sc.) nga fusha e shkencave kompjuterike nga Fakulteti e Shkencave Matematike – Natyrore të Universitetit të Prishtinës “Hasan Prishtina” me Dr.sc. Ermir Rugova, dhe Dr.sc. Alban Rrustemi, KSHC vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Këshillë juridike:** Kundër këtij vendimi mund të paraqitet kërkesa për rishqyrtim të vendimit sipas nenit 126, pika 2 a, të Ligjit mbi Procedurën Administrative nr. 02/L-28. Kërkesa për rishqyrtim të vendimit i dorëzohet këtij organi në afatin prej 30 ditëve siç është përcaktuar në nenin 130, pika 1 e Ligjit mbi Procedurën Administrative.

Vendimi iu dërgohet:

- Fakultetit të Shkencave Matematike – Natyrore të Universitetit të Prishtinës “Hasan Prishtina”;
- MASHT;
- Arkivit të AKA-së.



Prof. Asoc. Dr. Blerim Rexha  
Kryetar i Këshillit Shtetëror të Cilësisë